MANUAL PËRDORIMI PËR APLIKIMET E AQTN-SË

në portalin e-albania për shërbimet e AQTN-së

Abstract

Ky manual do të shërbej si udhëzues për qytetarët/bizneset për të bërë aplikimin për shërbimet e AQTN-së në portalin qeveritar www.e-albania.al

ARKIVI QËNDROR TEKNIK I NDËRTIMIT Info.aqtn@aqtn.gov.al

Tabela e Përmbajtes

1.	Hyrje	2
2.	Regjistrimi	2
3.	Logimi në portal	5
4.	Aplikimi për shërbimet e AQTN-së	6
a)) Kur do aplikojmë për herë të pare:	7
b) Kur kemi krijuar një aplikim më përpara, dhe duam të gjurmojmë statusin e aplikimit:	8
5.	. Pagesa në portalin e-Albania	9

1. Hyrje

Ky manual do të shërbej si udhëzues për qytetarët, për të aplikuar në portalin unik qeveritar e-Albania.al për shërbimet që ofron Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit. Çdo qytetar përdorues do të identifikohet në mënyrë unike në system me numrin personal të kartës ID dhe paswordin që keni vendosur. Nëse nuk jeni i regjistruar, si fillim duhet të regjistroheni në portalin e-albania.

SHËNIM: AKSESONI GJITHMONË SHËRBIMET NGA NJË SHFLETUES WEB, SI MOZILLA, CHROME, EDGE, SAFARI, ETJ DHE JO NGA APLIKACIONI MOBILE

2. Regjistrimi

Për tu regjistruar në portal, pasi të keni vizituar faqen <u>www.e-albania.al</u> klikoni ne linkun Regjistrohu, si ne figuren më poshtë.



Do ju shfaqet një dritare tjetër ku do jetë një text i shkruar në menyrë rastësore. Pasi te keni vendosur tekstin do klikoni ne butonin "Vazhdo".

Regjistrohu në e-Albania	
Provoni që nuk jeni robot. Ju lutem shkruani tekstin në CAPTCHA në mënvre që të verifikoni që jeni person. Më nas klikoni hutonin 'Vazhdo' nër të nërfund	iar procesin e
regjistrimit.	

Figure 2

Më pas do ju shfaqet dritarja e regjistrimit, ku do e plotësoni me te dhënat tuaja personale. Të dhënat duhet të jenë të sakta dhe pa gabime. Për tu regjistruar ju duhet të keni edhe numrin e telefonit si dhe një adresë email.

Pasi të keni plotësuar me sukses të gjitha të dhënat e kerkuara në fushat e kërkuara, klikoni në butonin "**Regjistrohu**", dhe Brenda pak sekondash do ju vi me mesazh një kod verifikimi, i cili duhet të vendoset në fushën e kërkuar Brenda 120 sekondave (2 minuta). Pas kësaj do ju shfaqet mesazhi që regjistrimi juaj u bë me sukses.

Regjistrohu në e-Albania

Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit)*:
J01234567U
Fjalëkalimi*:
Plotësoni fjalëkalimin
Fjalëkalimi përsëri*:
Riplotësoni fjalëkalimin
E-mail*:
example@domain.com
Numri i celularit*:
Οδικοχοροχ
Pyetja e sigurisë*:
Vendlindja e nënës 🗧 🗧
Përgjigjja e pyetjes së sigurisë*:
Emri*:
Atësia*:
Mbiemri*:
Datëlindja*:
dd.mm.vvw
Unë miratoj përdorimin e të dhënave të mia personale
(Të gjitha fushat me * janë të detyrueshme!) Lexo të plotë
Lutemi kontaktoni asistencën ndaj qytetarit duke klikuar këtë mesazh ose tek login@e-albania.al

3. Logimi në portal

Për tu loguar (identifikuar) në portal. Klikoni në linkun "**HYR**", që ndodhen ne pjesën sipërdjathtas të faqës <u>www.e-albania.al</u> (*figura 1*), dhe në faqen tjetër që do ju shfaqet, do klikoni në linkun "**Qytetar**".

e martë, 30 qershor 2020			
		Ju lutem zgjidhni mënyrën e identi	fikimit:
	Qytetar	Biznes	Administrata
Ð	ldentifikimi i punonjësve qeveritarë (GOV)	Identifikimi i punonjësve qeveritarë me certif	ikatê Identifikimi i qytetarêve me lexues karte identiteti

Figure 4

Në faqën tjetër do përdorni kredencialet tuaja për logim (**Numri Personnal NID dhe Password**) në fushat përkatëse, si në figurën më poshtë.

Shënim: **NID** është numri personal që ndodhet në kartën e Identitetit që fillon dhe mbaron me karakter/shkronjë.

Pasi të keni vendosur saktë të dhënat tuaja, klikoni në butonin "Hyr".

e enjte, 16 janar 2020	
	P.SH: G12345678H
<i>p</i>	
Keni harruar fjalëkalimin tuaj?	

Figure 5

4. Aplikimi për shërbimet e AQTN-së

Pasi të jeni identifikuar në portal, mjafton të kërkoni për shërbimet e AQTN-së, për të cilin doni të aplikoni. Tre shërbimet e AQTN-së për të cilët mund të aplikohet online janë:

- Marrje dosje pronësie (para viteve 1960)
- Marrje fletë projekti
- Marrje Gen-plan (A3/A4)

Mjafton të kërkoni në faqen kryesore te e-albania.al në fushën *"Kërko shërbimin"* (*figure.1*), dhe të zgjidhni një nga 3 shërbimet e AQTN-së:

KRYESORE E-SHËRE		IDIHMË DHE SUPORT	n Regjistro një biznes
Marrie decie prepăsie			~
G Manje dosje pronesie			
🕒 Marrje fletë projekti			
😑 Marrje Gen-plan (A3/A4)			
🛛 😉 Autorizim për rimarrjen e lej	edrejtimit pas humbjes totale të pik	ëve ose heqjes së saj	
Ø Kërkesë për pjesëmarrje në	aktivitete		
Overtetim për periudha pune	në ndërmarrje shtetërore (para datë	ës 01.01.1994)	
CERTIFIKATA ELEKTRONIKE	FAMILJA	ARSIMI	PUNA
 Pajisja me Nënshkrim Elektr Pajisja me Nënshkrim Elektr Aplikim për Certifikatë Ele 	 Leje për dalje Certifikatë personale Certifikatë familjare 	 Matura Shtetërore Kërkesë për kopje të testit Njësimi i diplomave 	 Leje Pune Vërtetim si punëkërkues Vërtetim për pagesën e papu
Të tjera	Të tjera	Të tjera	Të tjera
SHËNDETËSIA DHE MBROJTJA SOCIALE	KONTRIBUTET DHE PENSIONI	GJENDJA GJYQËSORE	BIZNESI IM
> Karta e Shëndetit	> Vërtetim për pagimin	> Dëshmia e Penalitetit	> Vërtetim për aktivitet ekon
> Kontrolli mjekësor bazë	Vërtetim pensioni	> Formulari dekriminalizimit	Aplikim për regjistrimin e
> Ndihma ekonomike	> Kërkesë për shpërblim lindj	Vërtetim i periudhës	Aplikim për ushtrimin e vep

Figure 6

Pasi të kemi klikuar një nga shërbimet, do ju hapet një dritare tjetër ku do keni një informacion më të detajuar rreth shërbimit, dokumentacionin e nevojshëm shoqërues (nëse ka) si dhe hapat e proçedurës. Për të vazhduar me proçesin e aplikimit, në fund të faqes do klikoni në butonin "**Përdor**", ku do ju dërgojë në faqen tjetër.

Në këtë hap, kemi dy opsione

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Për të krijuar një aplikim të ri klikoni butonin 'Krijo aplikim të ri'. Për të qjurmuar një aplikim ekzistues klikoni butonin 'Aplikimet e mia'
Krijo aplikim të ri Aplikimet e mia

Figure 7

a) Kur aplikojmë për herë të pare:

Klikojmë në butonin **"Krijo aplikim të ri"**, dhe do hapet dritarja me të dhënat tuaja si dhe me formularin e aplikimit, si më poshtë:

	MINISTRIA E INFRASTRUK DHE ENERGJISË	URĒS				
	SEKSIONI A: INFORMACION MBI APL					
		0				
Emri		Mbiemri				
Emri i babait		NID				
Gjinia	✓Mashkull [®] Femër	Datēlindja				
Vendlindja		Rrethi				
Qyteti*		Shtetësia*	Shqiptare			
Kodi postar*		E-mail 🚺				
Nr. Tel. Celular 🧻		Nr. Tel. Fiks				
Adresa*	*					
	SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK ME					
Chikim materialit	SHEMBULL: Aplikim për G	en-Plan A4	A3 ∕			
Viti i bartës*	107/	(Specifiko)*	1974 1986 dbe Azbornim			
Ovteti i hartës*	Tirane	Bruga/Zona*	Dr Dibres			
Të tjera 👔	Piese nga Relievi i Korces, Shk 1:500, Viti	Emertimi i hartes	Plansheta M-9			
Pjese	nga Relievi i Tiranës, Shk 1:500, SEKSIONI C DOKUMENTE OF NGARKOHEN					
Viti : Mari	1974, 1986 dhe Azhornim, re nga Plansheta M-9 (A4 - bardh e Zi)					
Vendndodhja në hart	ē		Përzgjidh	Ngarko		
📄 Mbledhja e dokur	nentacionit shoqërues të mësipërm që më parë ishte detyrim të dorëzohej në zyrat	e shtetit nga vetë aplikan	nti, tani është detyrë e nëpunësit të admi	nistratēs ndaj		
	qytetarit. Me klikimin e ketij butoni, ju bini dakord qe keto dokumente të siguronen per ju nga nepunësi i administratës.					
Apliko						

- Seksioni A përmban informacionin mbi aplikuesin. Fushat me ngjyre gri, plotesohen në mënyrë automatike nga të dhënat e marra nga regjistri i gjëndjes civile dhe e-albania.
- Seksioni B përmban detajet e aplikimit tuaj për *Hartën GenPlan/Dosjen ose Fletën e Projektit*. Duhet të keni kujdes të plotësoni qartë emërtimet që nevojiten për përfundimin e aplikimit. (*Shembull i plotësuar më sipër*).
- Vendodhja ne Hartë Mund të bashkangjitni një imazh të marrë nga GoogleMaps, ose nga portal ASIG, duke e shenuar pronen tuaj. Imazhi të jetë i qartë dhe në një shkallë të madhe, në mënyre që të kapi sa me shumë pjesë nga zona ku ndodhet banesa/prona që ju intereson ju. Kjo do ndihmoje edhe specialistet që ta kenë sa më të qartë objektin që ju kërkoni.

SHENIM: Fushat me simbolin (*) do te thotë që janë të detyrueshme. Pasi të keni përfunduar, klikoni në butonin "APLIKO".

b) Kur kemi krijuar një aplikim më përpara, dhe duam të gjurmojmë statusin e aplikimit dhe për të bërë Pagesën:

Klikojmë në butonin "**Aplikimet e mia**", dhe kjo do na shfaqë listen e të gjitha aplikimeve që kemi bërë për shërbimet e AQTN-së.

7	952	DHËNIE FLETË PROJEKTI	18.12.2019	Aplikim i ri	Shfaq Paguaj Dokumentet
Fig	ure 9				

Këtu do shfaqet edhe aplikimi juaj, i cili do kete Nr i Aplikimit (p.sh: 952), Emërtimin e Shërbimit (Dhënie Fletë Projekti), Datën e Aplikimit, Statusin dhe Butonat:

- Shfaq	- (Shfaq faturen të cilën ju do paguani).
- Paguaj	- (Bën pagesën e shërbimit për të cilën jeni faturuar).
- Dokumentet	- (Pasi të keni bërë pagesën do ju shfaqet lista me dokumentat
	e bashkngijtur, të cilën do mund ta shkarkoni).

Butonat do jenë JO-Aktiv, deri në momentin që specialistët e AQTN-së do kenë trajtuar aplikimin tuaj.

- Në rastin kur aplikimi juaj *Refuzohet*, do ju shfaqet një mesazh me arsyen e refuzimit si më poshtë:

7	952 DHËNIE FLETË PROJEKTI	18.12.2019	Aplikimi Refuzohet.Informacioni i dhënë nuk është i mjaftueshëm për dhënjen e shërbimit.	Shfaq Paguaj Dokumentet
---	------------------------------	------------	---	----------------------------

Figure 10

- Në rastin kur aplikimi *Aprovohet*, statusi do pershkruaj qe aplikimi eshte aprovuar, dhe butoni **Shfaq** dhe **Paguaj** do ju bëhen **AKTIV**, dhe konturi ka ngjyre të kuqe si në figurën më poshtë:

7	952	DHËNIE FLETË PROJEKTI	18.12.2019	Aplikim i ri	Shfaq Paguaj Dokumentet
---	-----	--------------------------	------------	--------------	----------------------------

Figure 11

5. Pagesa në portalin e-Albania

Pas aprovimit të aplikimit nga back-office, butoni SHFAQ dhe PAGUAJ do jenë aktiv, duke na mundësuar që të proçedojmë me pagesën online. Klikojmë në butonin PAGUAJ, dhe kjo do na dërgojë tek faqja tjetër, nga ku mund të zgjedhim bankën për të kryer pagesën e shërbimit tonë.

Credins - Kliko këtu / Click here	BKT - Kliko këtu / Click here	Reiffeisen Kliko këtu / Click here
Zgjidhni llojin e kartës (krediti ose debiti) për të kryer pagesën! Credit Card • Vazhdo me pagesën	BANKA KOMBETARE TREGTARE	
Për cilindo që zotëron një kartë krediti oso portali unik qeveritar e-albania nëpërmje platformës qeveritare të pagesave elektro	e debiti me logon VISA ose MASTERCARI t këtij kanali bankar ofron mundësinë e k nike thjeshtë dhe shpejtë, 24 orë në ditë	D, si brenda Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj, kryerjes së pagesave online nëpërmjet e në 7 ditë të javës.

Figure 12

SHENIM: Pagesa mund të bëhet nga të gjitha kartat **Credit** ose **Debit**, të cdo banke, por nëpërmjet kanalit të bankës CREDINS në e-Albania.

Pasi të kemi zgjedhur Bankën **CREDINS**, dhe llojin e kartës (*Krediti ose Debiti*) për të kryer pagesën, klikojmë në butonin Vazhdo me Pagesën.

Në hapin tjetër do shfaqet një përmbledhje e pagesës, si më poshtë:

Përmbledhje e pagesës / Payment summary				
DHENIE FLETE PROJEKTI				
Nid/Nuis	G0123456789H			
Nr. Fature / Invoice Number	AIB711300720PG0000000057999			
Gjeneralitete				
Emri / Name	Emẽr			
Mbiemri / Surname	Mbiemër			
Përshkrimi shërbimit / Service Description				
	Ju po paguani për shërbimin: DHËNIE FLETË PROJEKTI			
	Numri i aplikimit: 1042			
Vlera e shërbimit / Service amount	200 Lek			
Vlera totale / Total amount	200 Lek			
Vazhdo me Pagesë	n / Proceed with payment			
	DINS bank Ne flasim gjuhën tuaj:			

Figure 13

Klikojmë në butonin: Vazhdo me Pagesën.

Në hapin e fundit, do shfaqet dritarja ku do plotësohet me të dhënat e kartës tuaj si:

- Emrin dhe Mbiemrin
- Numrin e Kartës
- Datën e Skadencës
- CVV (është numër 3 shifror në anën e pasme të kartës)

Dhe pasi të keni plotësuar saktë këto të dhëna, klikoni në butonin PAGUAJ/PAY, si në figurën më poshtë:

VERIFIED by VISA		MasterCar SecureCod	d. le.	
- Kodi i Sigurisë	Û			
	Paguaj/Pay			
CVV2*:	123			
Vlefshmëria/Expiry:		02	/ 20	
Nr. i Kartës/Card No.:	1234 5678 9	1234 5678 9876 5432		
Kartëmbajtësi/Cardholder:	Emër Mbie <mark>m</mark> ër			
Vlera/Amount:	250.00 / ALL	250.00 / ALL		
	DHENIE FLE	TE PROJEKT		

Figure 14

<u>KUJDES</u>: Pasi të keni plotësuar të dhënat e kartës në formën më sipër pa hapsira mes numrave, <u>klikoni vetëm një herë</u> në butonin **PAGUAJ / PAY**, dhe prisni deri sa faqja të ju ri-drejtojë në portalin e-Albania, ku dhe do ju shfaqet mesazhi që " Pagesa u përfundua me sukses".

Pasi të këni ndjekur hapat dhe të keni bërë pagesën në portal, butoni **Dokumentet**, do aktivizohet, nga ku do mund të shkarkoni dokumentacionin e bashkangjitur.

#	Nr. i aplikimit	Tipi i aplikimit	Data	Statusi	()
1	952	DHËNIE FLETË PROJEKTI	18.12.2019	Aplikim i ri	Shfaq Paguaj Dokumentet

Figure 15

Pasi të klikoni në butonin "**Dokumentet**", në fund të faqes do ju shfaqet lista e dokumentave të bashkangjitur nga ku mund ti shkarkoni.

Shkarko dokumentet				
Nr	Titulli			
1	Plani i Qytetit Tiranës, me vulë	Shkarko		

Figure 16

- Fund -